Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0574

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahimi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "U – UNIQUE" SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "POLICIA E KOSOVËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të garazhës në kampin Enver Zymberi - Mitrovicë" me numër të prokurimit 214-24-1581-5-1-1, me 22/08/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "U – UNIQUE" SH.P.K. me nr. 2024/0574 , e datës 01/07/2024, kurse vendimi i AK "POLICIA E KOSOVËS" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të garazhës në kampin Enver Zymberi - Mitrovicë" me numër të prokurimit 214-24-1581-5-1-1, mbetet në fuqi.

2. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 13.03.2024, "POLICIA E KOSOVËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Ndërtimi i objektit të garazhës në kampin Enver Zymberi - Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 214-24-1581-5-1-1. Ndërsa me datën 13.06.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka

shpërblyer me kontratë OE: **“Euroing SHPK”-**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur,** lloji i kontratës: **- punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **607,440.98 €.**

Me 18.06.2024, OE “U – UNIQUE” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 20.06.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Me 01/07/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “U – UNIQUE” SH.P.K., me nr. 2024/0574 për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i objektit të garazhës në kampin Enver Zymberi - Mitrovicë” me nr. të prokurimit: 214-24-1581-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “U – UNIQUE” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Me datë 13.06.2024 kemi pranuar letrën standarde për tenderuesin e eleminuar.Me datë 13.06.2024 kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e të gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet. Për të pasur qasje jemi njoftuar me datë 13.06.2024 se dokumentet e kërkuara mund të na ofrohen me datë 14.06.2024 në ora 14:00.Gjatë analizës së letrës standarde për tenderuesin e eliminuar kemi vërejtur se komisioni i i vlerësimit pran AK: POLICIA E KOSOVES ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së dhe rregulloreve të prokurimit publik. Në vijim po ju paraqesim argumentet tona kundrejt Arsyes se anulimit nga AK-ja.

Pretendimi 1: “Shkelja nga AK-ja e Nenit 10 Mjetet për promovimin e Transparencës; Fillimisht ne qasjen ne dokumente pran zyrës se prokurimit nuk na është lejuar qasja ne te gjitha dokumentet qe kanë qen te kërkuara ne DT, qe rrjedhimisht i bie se ne nuk mund te vlerësojmë se a është i përgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë, si dhe pa qasje nuk mundem te cekim ndonjë krahasim me ofertën tone.

AK-ja nuk mundtë te mbaj si sekrete dokumentet qe janë esenciale për vlerësimin e tenderit, po ashtu mund te dëshmojmë se edhe ne rastet kur Ne kemi plotësuar kërkesën për sekret afarist, vet zyra e prokurimit ju ka dhënë te gjitha dokumente OE-ve tjerë, ku mund te konkludojmë se OE diskriminohen ne varësi se cila kompani është dhe sipas interesave personale te tyre.

Pretendimi 2: “Nenit 7 - Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminimi ne raport me OE tjerë; Për ne si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit është e pakuptimte se si AK – POLICIA E KOSOVËS neve si OE në procedura të ndryshme me kërkesa shumë të përafërta të na klasifikojë herë të pasuksesshëm dhe herë të eliminuar ku për dy aktivitetet kemi ofruar pothuajse të njëjtën listë të kontratave. Kjo tregon se AK po përdorë standarde të dyfishta, pabarazi dhe diskriminim gjatë vlerësimit të ofertave me qëllim të shpërblimit me kontratë OE qe janë duke u favorizuar thuajse ne secilin aktivitet te prokurimit pran Policisë se Kosovës, OE i rekomanduar për këtë aktivitet te prokurimit, zyra e prokurimit kanë një bashkëpunim edhe me kontratat tjera, ne jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse oferta jonë ka qenë më e lirë për 16,167.66 EURO, d.m.th jemi eliminuar për shkak se ju kemi prishur interesat ndokujt për brenda prokurimit.

Kjo arsye e eliminimit se kemi ofruar kontrata të pamjaftueshme në ndërtim nuk qëndron për arsye se të gjitha kontratat e bashkangjitura me pranime teknike nga ana jonë, janë ne përputhje te plote me kërkesën e DT-s dhe FDT-s saktësisht sipas kërkesës ne Nenin 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, dmth e plotësojnë 100% kushtin kërkuar (të natyrës së njëjtë dhe të ngjashme) tek Dëshmia e kërkuar dokumentare - Listën e kontratave të nënshkrua të natyrës së njëjtë apo të ngjashme. (Shih përshkrimin sipas DT-së)

Pra bazuar në DT komisioni ka pasur mundësi të kërkojë sqarime për secilën kontratë nëse ka pasur paqartësi për natyrën e punimeve, edhe pse vërehet qarte se janë te njëjta/ngjashme.

Më poshtë gjeni rekapitullimin për këtë aktivitet qe jemi eliminuar kundërligjshëm si dhe rekapitullimet e disa prej kontratave te bashkangjitura kësaj dosje për këtë aktivitet te prokurimit:

1. Rekapitullimi i aktivitetit: NDËRTIMI I OBJEKTITTË GARAZHËS NË KAMPIN ENVER ZYMBERI- MITROVICË, Nr. i Prokurimit 214-24-1581-5-1-1

Të gjitha pozicionet e cekura në paramasë korrespondojnë me referencat/kontratat e prezantuara nga ana jonë ku janë të përfshira punë te arkitekturës, instalime elektrike, makinerisë, ujësjellësit-kanalizimit.

(Rekapitullimi i me sipërm i këtij aktiviteti korrespondon me të gjitha rekapitullimet e kontratave tona në sqarimet e paraqitura me poshtë) Rregullimi I parkut ne qendër të fshatit Pllave me vlerë: 29,983.15 €

Kjo kontratë në vete përmban pozicione shumë të ngjashme me natyrën të kontratës (Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë)Ndërtimi dhe renovimi I objekteve shkollore me vlerë: 81,465.92 €

Vet titulli i kësaj kontrate thotë *ndërtimi dhe renovimi* andaj kjo kontratë është pikërishtë e njejtë me natyrën e kërkuar në DT.Renovimi i objektit të DPSF (Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjes) me vlerë: 48,440.84 €

Edhe kjo kontratë në vete përmban pozicionë shumë të ngjashme me natyrën e kontratës (Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë)- 024-Renovimi I objekiit të Qkmf-se Dragash me vlerë: 69,368.70 €

Gjithashtu edhe kjo kontratë në vete përmban pozicionë shumë të ngjashme me natyrën e kontratës (Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë)

Punimi I hapësirave për kabinete, ne nen kulmin e shkollës Sinan Thaqi ne fshatin Zojz me vlerë: 94,413.57 €

Nuk mund ta kuptojmë se si një kontratë e tillë është injoruar nga AK me arsyetimin se nuk është e natyrës së njëjtë ose të ngjashme ku pikërisht kjo kontratë përmban shumë pozicione të njëjta me natyrën e këtij aktiviteti (Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë).Renovimi i objekteve ekzistuese në Institutin Special në Shtime me vlerë: 64,373.00 €

Edhe kjo kontratë është e natyrës së ngjashme dhe shumë pozicione të kësaj kontrate janë të njëjta me natyrën e pozicioneve në këtë aktivitet. (Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë). - 071 -Renovimi I QMF-ve në Bresanë, Uapushnik, Bellobrad si dhe AMF-ve në Blaç dhe Kosavë-Ritenderim me vlerë: 63,360.00 €

Kjo kontratë ka të bëjë me renovimin e 5 ambulanteve në disa fshatra të komunës së Dragashit ku si pozicione të punës janë: *Punët e Arkitekturës, Instalimeve të Ujësjellësit, Elektrikes, Makinerisë. Pra* të gjitha këto pozicione janë pikërisht pozicionet e njejta me natyrën e kontratës në këtë aktivitet.

• 118- Ndërtimi i studionit në Krevecices në fshatin Pllav me vlerë: 22,222.22 € (Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë).

- Ndërtimi i stadiumit në fshatin Blaq - (projekt dy vjeqar) me vlerë të realizuar: 106,903.00 < (Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë).Realizimi i punimeve ndërtimore për funksionalizimin e Pediatrisë ne SP Mitrovicë | me vlerëu218,980.21 €(Shih rikapitulimin e paramases për këtë kontratë). - Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo (SEEK) me vlerë: 433,080.22 € (Shih rekapitullimin e paramasës për këtë kontratë).

Kjo kontratë përmban në vete punë ndërtimore në kursimin e energjisë me ç 'rast kompania jonë ka kryer këto punime në gjithsejtë 31 Shtëpi banimi në tërë territorin e Kosovës ku Efiqienca e Energjisë është arritur gjatë realizimin të punimeve të Arkitekturës (Fasadimit të objekteve, Punët e kulmit në objekte, Punë të Zdruktharisë) dhe Punë të Makinerisë. Pra të gjitha këto punime janë të natyrës së njëjte ose të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit.

Këto janë disa nga kontratat e paraqitura në listën e dorëzuar ku vetëm këto kontrata arrijnë vlerën 1,232,590.83 €, ku te gjitha këto kontrata të paraqitura në listë janë sipas kërkesës në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit.

Nëse krahasohen rekapitullimet e kontratave te përfunduara me rekapitullimin e paramasës se ofertës se këtij aktiviteti atëherë, kjo nuk do analizë të thellë për ta kuptuar se kontratat tona janë të njëjta dhe të ngjashme me natyrën e këtij aktiviteti, qe rrjedhimisht AK-ja na ka diskriminuar kundërligjshëm.

Dëshmi tjetër se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat është emaili i drejtuar kompanisë certifikuese për ISO 3834-2 dhe e-maili drejtuar stafit tonë për verifikim të dokumentacionit, ku po të mos ishin plotësuar të gjitha kërkesat komisioni nuk do kishte kërkuar sqarime të tilla sepse qëllimi i AK-së ka qenë eliminimi i kompanisë tonë, me çdo kusht, dmth ka vepruar me dy tri standarde deri sa e kanë binde veten e tyre që të na eliminojnë pa arsye. Pra në DT janë kërkuar kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme dhe nuk mund ta kuptojmë se si AK-Komisioni vlerësues i injoron kontratat tona dhe tregon se qëllimi i tyre ka qenë eliminimi jonë nga ky aktivitet i prokurimit me një vendim skandaloz dhe aspak profesional.

AK - Komisioni i vlerësimit ka shkelur Nenin 40 pika 40.2 ku autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose largojë kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, andaj ky eliminim nga ana e AK-së është ne kundërshtim me LPP-në, Rregulloren 001/2022 sepse ne si OE kemi ofruar Referenca te ngjashme me natyrën e kontratës ne vlerë: 1,499,956.77 Euro, ku kjo vlerë është dukshëm më e madhe se vlera e kërkuar nga AK (600,000.00 Euro).

Gjithashtu AK me anë të këtij vendimi ka bërë shkelje të:

Nenit 1 – Qëllimi: “AK këtë ligj nuk e respektoi për faktin se nuk siguroi në mënyrë efikase dhe transparente shfrytëzimin e fondeve publike.

Gjithashtu disa nga anëtarët e komisionit vlerësues shkelën mbi integritetin dhe përgjegjësin e vet si zyrtar publik të përfshirë në këtë aktivitet të prokurimit ku të ndikuar në interesat personale apo me rekomandime te ndokujt tjetër, pra shfaqen diskriminim gjatë vlerësimit të ofertave duke

i lënë anash kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji dhe me anë të këtyre shkeljeve është shkelur edhe pika 3 e këtij ligji ku ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 - Ekonomicitefi dhe Efikasiteti: Oferta jonë është me çmimin më të ulët për 16,167.66 EURO pra ashtu siç është është përcaktuar në FTD - Kriteri i dhënies - Çmimi më i ulët dhe AK me vendimin e saj nuk arriti të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Nenit 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave AK dhe komisioni vlerësues përmesë Njoftimit mbi vendim dhe letrës standarde ka bërë shkelje të këtij neni sepse nuk e respektoi kriterin kryesor për dhënie të kontratës – Çmimi më i ulët dhe duke anashkaluar ofertën tonë bëri përzgjedhje të pa drejtë të pjesëmarrësve ku vlerësoi një oferte me çmim më të lartë si të përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit.

Nenit 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve AK bëri shkelje të këtij neni sepse duke e parë që të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit janë në përputhshmëri nga ana jonë duke e plotësuar në përpikëri secilën pikë të FTD-së ofertën tonë nuk e konsideroi të përgjegjshme me një vlerësim jo profesional dhe të pa analizuar mirë, bazuar ne sqarimin e Pretendimit nr. 2 siç e sqaruam me lartë.

Nenit 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës: Ky nen nuk u respektua fare edhe për faktin se oferta jonë është oferta me Çmimin më të ulët ashtu siç është përcaktuar në FTD - Kriteri i dhënies - OE i përgjegjshëm me Çmimin më i ulët, ku ne rastin konkret jemi ne U-UNIQUE SHPK qe e plotësojmë këtë kriter.

Nenit 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale: "AK përmesë Njoftimit mbi vendim dhe letrës standarde ka bërë shkelje të këtij neni për faktin se edhe në raportin e komisionit vlerësues shihet qartë se të gjitha kriteret teknike dhe profesionale të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit janë plotësuar nga ana jonë dhe me qëllim të eliminimit tonë përdorë vetëm një fjali të shkruar Citojmë pjesë nga letra standarde: OE *ka ofruar dëshmi të pamjaftueshme për ndërtim* duke e lënë anash edhe kërkesën ne DT-së ku thuhet natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit. Nuk mund ta kuptojmë se si për një kërkesë ku vlera e kërkuar ka qenë 600,000.00 Euro nuk janë të mjaftueshme kontrata në vlerë prej 1,499,956.77 Euro. Andaj komisioni vlerësues ka bërë shkelje skandaloze të këtij neni duke mos analizuar fare dhe injoruar kontratat e paraqitura nga ana jonë të cilat janë në përputhje të plotë me natyrën e kontratës dhe me kërkesat në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. bazuar ne sqarimin e Pretendimit nr. 2 siç e sqaruam me lartë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "U – UNIQUE" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 10, 56, 59, 60 dhe 69 te LPP-së. Duke propozuar qe për Arsyet dhe faktet e paraqitura më lartë, dhe për shkakë që të mos dëmtohet interesi publik nga mundësia e marrjes së shërbimeve me kohë, dhe në anën tjetër që të ndalet dhe të parandalohet dëmi serioz që është shkaktuar në drejtim të parashtruesit të ankesës duke iu mohuar të drejtën ligjore që të shpërblehet me kontratë pasi nuk ka asnjë bazë ligjore që të veprohet ndryshe, kërkojmë që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe provave të paraqitura, ZPP pran POLICISE SE KOSOVËS të merr vendim: APROVOHET si e bazuar ANKESA e OE " U - UNIQUE " SH.P.K. ANULOHET Njoftimi i vendimit të Autoritetit Kontraktues për Njoftim për vendimin e AK-së të datës 13.06.2024 Lënda të kthehet në RIVLERËSIM duke marrë parasysh të gjitha gjetjet të cilat janë lartcekur dhe me rastin e rivlerësimit të jetë në harmoni me kërkesat ligjore si dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i aktivitetit është marrja e furnizimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që janë ndjek, të drejtat që janë respektuar dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 6 të LPP-se pasiqë Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike do të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Autoriteti kontraktues nuk e ka shkelur nenin 7 te LPP Barazia ne trajtim dhe jo diskriminim nuk qëndron .

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Andaj AK i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë Operatoret Ekonomik bazuar në kërkesat teknike dhe profesionale te Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteteve të prokurimit, AK - Polica e Kosovës do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, e dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës , FDT që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse dhe AK ka vepruar ne harmoni te plote me LPP- dhe RRUOPP-ne dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Nenit 56 - Dispozitat e pergjigjthshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konform kritereve te përcaktuara në Dosjen të Tenderit dhe në Njoftim për Kontrate dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e vendosura në Dosje te Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë me çmim me te lire te përgjegjshëm. Andaj pretendimi qe AK ka bere shkelje nuk qëndron.

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Pretendimi se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së, nuk qëndron sepse ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Pikërisht eliminimi i OE ankues është bërë duke pasur parasysh nenin 59 të LPP pasi që në nenin 59.4 ceket qartë se kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njofümin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, ndërsa tenderi i OER ankues nuk ka qenë në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit.

Neni 60 -Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 60

Pretendimi qe Autoriteti kontraktues ka shkele nenin 60 nuk qëndron . Autoriteti kontraktues ka vepruar ne harmoni te plote me LPP, me kriteret e DT dhe Njoftimit për kontrate , andaj pretendimi është i pabazuar. Kriter kryesor ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Pretendimi qe AK ka shkelur nenin 69 nuk qëndron, përkundrazi I ka trajtuar me kujdes te gjithë OE-te oferuese dhe I ka trajtuar te gjitha kriteret sipas DT dhe Njoftim për Kontratë

Oferta e OE-së ankuese nuk I ka plotësuar kriteret dhe ka dështuar sepse sipas arsyetimit ne LetraStandarde:

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 600,000.00 €

Dëshmi I-Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse, për punët e realizuara dhe pranuar , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve.

Kur ndërtimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë.

- Kur ndërtimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontratë nuk do te Llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e punëve ose raportet e pranimeve teknike përfundimtar.

Operatori ekonomik në kërkesë për rishqyrtim vetëm e ka potencuar se e plotëson kërkesën në lidhje me kontratat, ndërsa nuk ka dhënë asnjë dëshmi apo argument se cilat kontratë janë në ndërtim.

Fillimisht sqarojmë se në kërkesë është cekur saktë kur ndërtimi është bërë për një autoritet publik cilat dëshmi duhet të ofrohen, e po ashtu edhe kur ndërtim është bërë për një blerës privat cilat dëshmi duhet të ofrohen, prandaj lista e kontratave me dëshmi e OE ankues nuk përkon me kërkesën dhe nuk arrihet vlera e kërkuar sipas dosjes së tenderit prej 600, 000.00 € .

Pra termi ndërtim është përdorur tek dëshmia e kërkuar dokumentare dhe është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues, se në dosje të tenderit nuk janë kërkuar kontrata në ndërtim.

OE ankues ka pretenduar se e tërë lista e kontratave është kontrata të ndërtimit, mirëpo kjo është e paqëndrueshme dhe jo e saktë.

Siç shihet nga lista e prezantuar dhe nga dëshmitë tjera, një pjesë e kontratave janë të përfunduara me renovime, sanime, instalime elektrike, kanalizim etj., prandaj këto kontrata nuk mund të merren parasysh dhe nuk janë sipas kërkesës së FDT-së dhe sipas njoftimit për kontratë.

Pretendimi i OE ankues se këto kontratë janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara.

Madje edhe vetë OE ankues e potencon se kontratat e prezantuara përfshijnë, punë, gërmime, zhavorime, ndërtime, instalime elektrike etj, prandaj edhe nga ky pretendim kuptohet se OE ankues nuk ka kontrata të nderimit në vlerën e kërkuar apo të ngjashme. Kontrata të natyrës së ngjashme janë ato kontrata të ndërtimit, si ndërtim të shkollave, palestrave ndërtime të banesave, ndërtime të shtëpive apo të tjera, por që janë ndërtim, e nuk konsiderohen natyrë e ngjashme renovimet, instalimet elektrike etj.

Po ashtu është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues se në procedura të ndryshme me kërkesa shumë të përafërta klasifikohen herë të pasuksesshëm dhe herë të eliminuar ku për dy aktivitetet kanë ofruar pothuajse të njëjtën listë të kontratave. Aktivitetet e prokurimit janë të ndryshme dhe secili aktivitet i prokurimit i ka të përcaktuara kërkesat e dosjes së tenderit dhe vlerësimi bëhet mbi bazën e këtyre kërkesave, prandaj kur i plotëson kërkesat e dosjes cilësohet i përgjegjshëm, ndërsa kur nuk i plotëson kërkesat normalisht që konsiderohet tenderues i eliminuar.

OE ka ofruar dëshmi te pamjaftueshme për ndërtim sipas kërkesës se ne DT dhe Njoftim për Kontrate. Dëshmitë e ofruara janë përgjithësish renovime dhe ndërtime te ulëta ku bien ndesh me kërkesën e specifikuar ne DT dhe Aneks për kontrate .Andaj oferta i refuzohetOE ankues vetëm ka përshkruar dispozitat e LPP-së, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka argumentuar se janë shkel këto dispozita të LPP-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 05.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0574/2024, ndërsa me datë 18.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0574 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "U – UNIQUE" SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0574 ka vlerësuar si në vijim:

Aktivitetin i prokurimit me titull: "NDËRTIMI I OBJEKTIT TË GARAZHËS NË KAMPIN ENVER ZYMBERI-MITROVICË" me nr. të prokurimit: "214-24-1581-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, me procedurë të hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

AK me datë 12.06.2024 publikon njoftimin B58 mbi rekomandimin për kontratë OE “Euroing” SHPK ndërsa OE ankuesi është i eliminuar me arsyetimin:

OE ka dështuar ne kriterin:“Kërkesa I Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 600,000.00 € Dëshmi l-Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjalë 3 (tri) vitet e fundi (nga data c publikimit te njoftimit për kontrate), te nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuara me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatëse. për punët e realizuara dhe pranuara . te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurim ose kontratës, vlerën c kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e punës dhe vendin e realizimit te punëve. • Kur ndërtimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër (jashtë RKS), për dëshmi duhen te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete c cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. • Kur ndërtimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikatë e pranimit ose referenca. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e punëve ose raportet e pranimeve teknike përfundimtarOE ka ofruar dëshmi te pamjaftueshme te për ndërtim sipas kërkesës se ne DT dhe Njoftim për Kontratë. Dëshmitë e ofruara janë përgjithësish renovime dhe ndërtime te ulëta ku bien ndesh me kërkesën e specifikuar ne DT dhe Aneks për kontrate. Andaj oferta i refuzohet”.

Si rrjedhojë, OE ankuesi në ankesë pretendon se AK ka eliminuar të njëjtin padrejtësisht, përkundër që ofron çmimin më të ulët.

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, natyra e aktivitetit të prokurimit është ndërtim i garazhës për veturat e blinduara, të cilët në E-prokurim kanë paraqitur specifikacionin teknik, dhe skicat me vizatime të ndërtimit.

Pas analizimit të arsyes së eliminimit të OE ankues sqarojmë se, i njëjti posedon listën e projekteve të përfunduara brenda tri viteve, të cilat sipas listës së dëshmuar, i njëjti posedon projekte të ndryshme si, ndërtim, renovim, inventarizim, molerim, rregullim te parkut etj. Përderisa AK në DT ka kërkuar që të ofrohen projekte të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, i cili specifikon tek dëshmia e kërkuar që:

Mirëpo, duke qenë se AK nuk ka specifikuar se cilat nga projektet nuk i plotëson kërkesën, atëherë si e tillë, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK duhet që në rivlerësim gjatë analizimit të ofertave, tek arsyet e eliminimit ti specifikoj se cilat nga projektet nuk hyjnë sipas kërkesës së dosjes së tenderit!

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti ekspertit shqyrtues, është hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në kontest me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Gjë që eksperti shqyrtues nuk i ka zbatuar në tërësi detyrat dhe përgjegjësit e tij.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Si rrjedhojë, Paneli shqyrtues në këtë rast nuk mund t'i mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues i cili nuk ka bazë as edhe një bazë ligjore dhe provë për ta kthyer aktivitetin e prokurimit publik në ri-vlerësim. Paneli shqyrtues për ankesën e parashtruar me numër protokolli: 2024/0574, e ka analizuar Raportin e ekspertit shqyrtues, të hartuar nga eksperti me kërkesën e OSHP për të shqyrtuar bazën ligjore të pretendimeve ankimore, të operatori ekonomik ankues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit të garazhës në kampin Enver Zymberi - Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 214-24-1581-5-1-1 të autoritetit kontraktues, Policia e Kosovës. Paneli vëren se eksperti shqyrtues nuk ka analizuar të gjitha shkresa e lëndës përfshirë edhe përgjigjen e autoritetit kontraktues në kërkesën për rishqyrtim ndaj operatorit ekonomik ankues. Ankues atakon arsyen e eliminimit te tij/saj, ku sipas Autoriteti Kontraktues, ankuesi nuk ka prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën e përcaktuar te FTD-se, ku AK - Policia e Kosovës ka eliminuar ankuesin se i njëjti nuk ka plotësuar Kerkesën rreth realizimit të kontratave "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate)

jo me pak se 600,000.00 €" Lidhur me këtë Eksperti shqyrtues për veq që sqaron llojin e ndryshëm të kontratave të cilat i ka ofruar ankuesi ai bie ndesh dhe pas asnjë konstatim konkret dhe pa ju drejtuar fare as edhe AK, citat: "*Mirëpo, duke qenë se AK nuk ka specifikuar se cilat nga projektet nuk i plotëson kërkesën, atëherë si e tillë, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK duhet që në rivlerësim gjatë analizimit të ofertave, tek arsyet e eliminimit ti specifikoj se cilat nga projektet nuk hyjnë sipas kërkesës së dosjes së tenderit! Andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar, duke rekomanduar që AK të kthej lëndën në rivlerësim*."

Për Panelin Shqyrtues ky konstatim i ekspertit përveç që është kontradiktor dhe bien ndesh me vetveten i njëjti nuk është as konform dispozitave ligjore dhe i argumentuar. Andaj, e mbështet vendimin e autoritetit kontraktues rreth arsyes së eliminimit të ankuesit duke u bazuar edhe në opinionin Nr. 11 të KRPP, i cili citon: "Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në që rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik. Kështu që, paneli shqyrtues konstaton se veprimet e AK janë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë oferta e OE ankues është refuzuar.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore të ankuesit në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në rivlerësim dhe vetëm me një pretendim të pjesërishëm dhe i pa argumentuar me sqarime dhe dispozita ligjore, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Vlenë të potencohet se autoriteti kontraktues është përgjegjës së konform nenit 24.2 të LPP, që aktivitetet e prokurimit ti zhvilloj konform dispozitave ligjore për prokurim publik që janë në fuqi. Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..."

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me "Ndërtimi i objektit të garazhës në kampin Enver Zymberi - Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 214-24-1581-5-1-1 të mbetet në fuqi.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **" U - UNIQUE " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: